



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 71/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.B, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji, me seli në Prishtinë, rr. “Bekim Fehmiu”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shpresa Musliu, për shkak të anulimit të vendimit nr. V_953_2019 të datës 29.03.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 13.10.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 21.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. V_953_2019 të datës 29.03.2018 të nxjerrë nga i padituri Zyra e Rregullatorit për Energji.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KES/CO), ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) nr. V_953_2019 të datës 29.03.2018, si jo i ligjshëm, me arsyetimin se faturimi i bërë në muajin 01/2016 tek konsumatori J.R. DPR 90109837 është faturim real i cili ka pasqyruar energjinë e shpenzuar nga kyçja e tij me datë 08.11.2015 deri në ditën e leximit datë 29.01.2016. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka shtuar se paraprakisht i gjithë objekti ku gjendet edhe konsumatori në fjalë ka pasur një njehsor indirekt apo grup matës në të cilin është faturuar energjia e shpenzuar deri me datë 17.11.2015 kurse pas kësaj date nuk është regjistruar. Ky grup matës në periudhën kontestuese nuk ka matur në mënyrë të saktë për shkak të lidhjeve të gabuara e që vërtetohet edhe nga fakti se nga data 17.12.2015 deri 12.01.2016 te ky grup matës kemi vetëm gjashtë intervale nga 15 minuta kur është regjistruar energjia e shpenzuar. Gjithashtu ka theksuar se nuk mund të merret e saktë analiza e të paditurit se shpenzimet e konsumatorit J.R për periudhën 02.2016 deri 08.2017 janë shumë më të ulëta se fatura kontestuese kurse vetëm

fatura 01.2016 ka një shpenzim shumë më të lartë se faturat tjera pasi që fatura 01/2016 përfshinë shpenzimet që janë bërë për një periudhë përafërsisht tre mujore dhe nuk pasqyron vetëm shpenzimet për një muaj siç është rasti tek faturat tjera, prandaj gjykatës i ka propozuar që të aprovet padia e paditësit KES/CO ashtu që të shfuqizohet në tërësi vendimi i të paditurës ZRRE si i pabazuar.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i Bordit të ZRRE-së është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë si dhe të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë pasi që ZRRE ka gjetur se tek konsumatori J.R ekzistojnë dy procesverbale të regjistrimit të njehsorit elektrik të bërë nga vetë KEDS, e të cilët janë kontradiktor me njëri tjetrin dhe se për këtë nuk është dhënë asnjë sqarim dhe se nga Pëlqimi Elektroenergjetik (PEE) nr. 8707 i datës 22.10.2015 në të cilin theksohet se me kërkesë të palës bëhet ndarja e pikës matëse dhe se në pikën 3 të PEE është theksuar se matja e energjisë elektrike bëhet veçmas për secilin lokal, ndërsa njehsori elektrik ekzistues nr. 96256351 mbetet njehsor kontrollues. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se kjo pikë matëse është dashur të faturohet nga data 12.01.2016 kur është instaluar njehsori elektrik duke i zbritur kilovatët që tashmë kanë qenë të regjistruar në procesverbalin për regjistrimin e njehsorit dhe se për rastin e njëjtë për datat e njëjta konsumatori A.H ka paraqitur ankesë në ZRRE dhe më pas KESCO ka iniciuar konflikt administrativ ku i është refuzuar padia si e pabazuar dhe i njëjti vendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, andaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe Vendimi i Bordit të ZRRE-së të mbetet në fuqi.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim i Bordit të ZRRE V_953_18 i datës 29.03.2018; Vendim i DMK V_1630_09_17 i datës 21.09.2017; Transaksionet e konsumatorit B... Sh.p.k., Transaksionet e konsumatorit J.R; Transaksionet e konsumatorit F... Sh.p.k; Transaksionet e konsumatorit R... Sh.p.k.; Transaksionet e konsumatorit NT R... ; Transaksionet e konsumatorit A.H; Faturat e konsumatorit B... Sh.p.k., Kundërshtim i KECO i datës 12.10.2017; Vendim i KESCO i datës 10.03.2016; Formular i ankesës i datës 29.01.2016; Procesverbal nr.1768652 i datës 23.02.2016; Ankese e datës 10.03.2016; Raport i korrigjimit nga KESCO ID lëndës: 8800005; Proces për pranimit të instalimit elektrik nr. 059905 i datës 12.01.2016; Proces për pranimit të instalimit elektrik nr. 0088147 i datës 12.01.2016; Formular i aplikimit për kyçje të re i datës 06.01.2016; Raport i KESCO për korrigjim nr. 40736; Pëlqim elektroenergjetik nr.

8707 i datës 22.10.2015 me shkresat përcjellëse; Urdhërpagese nr. 304/10/15 e datës 23.10.2015; Fletëpagesë e datës 23.10.2015; Raport teknik mbi pranimin intern nr. 11279 i datës 30.12.2015; Aktgjykim AA.nr. 247/21 i datës 17.05.2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Aktgjykim A.nr.1181/18 i datës 15.01.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me Vendimin e Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK-së) ZRRE/DMK_V_1630_09_17 të datës 21.09.2017, është aprovuar ankesa e konsumatorit Jetmir Rexhepi, dhe në pikën I është obliguar KES/CO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 9019837 nga fatura e energjisë elektrike nr. 01160DPR-90109837 (01/2016) në vlerë prej 3,375.90€ dhe në pikën II është obliguar KES/CO që për faturën e muajit 01/2016 konsumatorin me shifër DPR-9019837 ta ngarkoj me shpenzimin e energjisë elektrike prej TL=1542 kWh dhe TU=1771 kWh.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin, me datë 12.10.2017 ka ushtruar kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, të cilët me Vendimin V_953_2019 të datës 29.03.2018 kanë refuzuar si të pabazuar ankesën e KES/CO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Jetmir Rexhepi, me shifër të konsumatorit DPR – 90109837 dhe kanë lënë në fuqi vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_1630_09_17 i datës 21.09.2017

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 15 par. 1, nën-par. 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë të cilët përcaktojnë: *“1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: ... 1.8. të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të licencuarve me rregulla adekuate për zgjidhje të kontesteve; 1.9. të sigurojë se interesat në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë balancohen në mënyrë adekuate dhe se mbrohen konsumatorët në nevojë;”* si dhe në kuptim të nenit 17 par. 1 që përcakton se: *“1. Rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat: 1.1. nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara;”*. Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 14, 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë (Rregulla ZRRE/Nr. 04/2017 e datës 16 mars 2017) që përcaktojnë kompetencën e DMK-së pranë ZRRE për trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj vendimeve që merren nga

furnizuesi apo operatori i sistemit si dhe kompetencën e Bordit të ZRRE-së për vendosjen për ankesat ose kontestet ndaj vendimeve të DMK-së.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara.

Nga prova Formular i ankesës i datës 29.01.2016, gjykata ka konstatuar se konsumatori Jetmir Rexhepi me datë 29.01.2016 ka parashtruar ankesë tek paditësi për lexim jo të rregullt me kërkesë për rishqyrtim të faturës në vlerë 3,375.90€ dhe të njehsorit.

Nga prova Vendim i KESCO i datës 10.03.2016, gjykata ka konstatuar se paditësi ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit J.R dhe ka bërë korigjim në vlerë 217.41€ dhe nga prova Ankesë e datës 10.03.2016 gjykata ka konstatuar se konsumatori J.R ka parashtruar ankesë tek i padituri kundër vendimit të paditësit.

Nga prova Transaksionet e konsumatorit J.R, gjykata ka konstatuar se paditësi me datë 29.01.2016 ka faturuar konsumatorin J.R në shumë prej 3,375.90€, ndërsa me datë 02.03.2016 është bërë korigjimi i shumës 217.41€.

Nga prova Procesverbal nr.1768652 i datës 23.02.2016 gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë evidentimin e gjendjes reale të njehsorit nr. 64447885 ku është konstatuar hargjimi në tarifën I: 019186 kWh dhe në tarifën II: 00857 kWh.

Nga prova Raport i korigjimit nga KESCO ID lëndës: 8800005, gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë korigjimin e shumës prej 217.41€ sipas ankesës së konsumatorit.

Nga prova Proces për pranim të instalimit elektrik nr. 059905 i datës 12.01.2016, gjykata ka konstatuar se tek konsumatori J.R është bërë instalimi i njehsorit elektrik nr. 64447885 dhe në momentin e instalimit, datë 12.01.2016 ka pasur të regjistruar shpenzimet TN = 000000/16155 kWh dhe TU = 000000/4466 kWh.

Nga prova Proces për pranim të instalimit elektrik nr. 0088147 i datës 12.01.2016, gjykata ka konstatuar se tek konsumatori J.R është bërë instalimi i njehsorit elektrik nr. 64447885 dhe në momentin e instalimit, datë 12.01.2016 ka pasur të regjistruar shpenzimet TN = 16155/- kWh dhe TU = 4466/- kWh si dhe në fund është bërë shënimi: *“Rexhistrohet njehori me gjendje fillestare I = 016155 dhe II = 004466...”*

Nga prova Pëlqim elektroenergjetik nr. 8707 i datës 22.10.2015 me shkresat përcjellëse, gjykata ka konstatuar se me kërkesë të palët është bërë ndarja e matjes së energjisë elektrike dhe se njehsori elektrik me nr. 96256351 ka mbetur si njehsor kontrollues dhe nga provat Urdhërpagese nr. 304/10/15 e datës 23.10.2015 dhe Fletëpagesë e datës 23.10.2015 gjykata ka konstatuar se konsumatori ka bërë pagesën e shpenzimeve sipas PEE-së.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me faktin se është obliguar KES/CO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 9019837 nga fatura e energjisë elektrike nr. 01160DPR-90109837 (01/2016) në vlerë prej 3,375.90€ dhe në pikën II është obliguar KES/CO që për faturën e muajit 01/2016 konsumatorin me shifër DPR-9019837 ta ngarkoj me shpenzimin e energjisë elektrike prej TL=1542 kWh dhe TU=1771 kWh.

Gjithashtu gjykata e ka vlerësuar si të drejtë arsyetimin e ZRRE se ekzistojnë dy procese për pranim të instalimit elektrik dhe në të dy proceset është konstatuar gjendjen e ndryshme e shpenzimeve të njehsorit dhe se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e konstatuar në procesin nr. 0088147 duhet të zbritet nga faturimi që është bërë nga KESCO. Ndërlidhur me këtë, gjykata gjatë vlerësimit të dy Proceseve ka konstatuar se Procesi nr. 0088147 i datës 12.01.2016 është i nënshkruar edhe nga konsumatori dhe po ashtu ka të konstatuar faktin se *“Rexhistrohet njehori me gjendje fillestare I = 016155 dhe II = 004466...”* ndërsa Procesi nr. 059905 i datës 12.01.2016 nuk është i nënshkruar nga konsumatori, për çfarë gjykata vlerëson se ZRRE ka vepruar drejtë kur gjendjen faktike e konstatuar në bazë të procesit nr. 0088147 të datës 12.01.2016 dhe ka bërë kalkulimin e shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit duke bërë zbritjen e shpenzimet të konstatuara në procesverbalin nr. 0088147 pasi që ky shpenzimin nuk ka qenë i konsumatorit dhe nuk është bërë nga data e pranimin të njehsorit.

Gjithashtu gjykata vlerëson se korrigjimi i bërë nga paditësi është në kundërshtim me Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji (Rregulla ZRRE/Nr. 12/2017, 13 prill 2017) në nenin 5 par. 1, pika 1.5 që përcakton se: *“1. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të: 1.5. paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja;”* dhe në pikën 1.6. përcakton se: *“marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me energji të cilësisë së dobët dhe shërbim, që nuk është në përputhje me*

kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohen konsumatorëve.”

Gjithashtu në nenin 28 par. 1, 2 dhe 3 përcaktohet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.”*

Prandaj, gjykata vlerëson se ZRRE ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit kundër Vendimit të DMK-së me të cilin është aprovuar ankesa e konsumatorit J.R, dhe është obliguar KES/CO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 9019837 nga fatura e energjisë elektrike nr. 01160DPR-90109837 (01/2016) në vlerë prej 3,375.90€ dhe në pikën II është obliguar KES/CO që për faturën e muajit 01/2016 konsumatorin me shifër DPR-9019837 ta ngarkoj me shpenzimin e energjisë elektrike prej TL=1542 kWh dhe TU=1771 kWh.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara në këtë çështje, si Transaksionet e konsumatorit B... Sh.p.k., Transaksionet e konsumatorit F... Sh.p.k; Transaksionet e konsumatorit R... Sh.p.k.; Transaksionet e konsumatorit NT R...; Transaksionet e konsumatorit A.H; Faturat e konsumatorit B... Sh.p.k., Raport i KESCO për korrigjim nr. 40736; Raport teknik mbi pranimin intern nr. 11279 i datës 30.12.2015; Aktgjykim AA.nr. 247/21 i datës 17.05.2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Aktgjykim A.nr.1181/18 i datës 15.01.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin relevante me çështjen dhe me ndikim për vendosje ndryshe.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.47/22, datë 21.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.